# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-477520**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Java nis me përplasje! Meri Shehu ngre alarmin për disa shenja |
| ADRESA | `https://lajmifundit.al/java-nis-me-perplasje-meri-shehu-ngre-alarmin-per-disa-shenja-i1339054` |
| BURIMI | lajmifundit.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 19:35:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 21:27:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `428dd3d1d9993345419e061a911740ced4fd563de49657114d18ba2a080d3096` |
| TEKSTI | `6e3a1f65c0ea7e4a068afa3f6be8e1f6bd413d23b1496bf8279437bc63077897` |
| PAMJA | `61fe839949024e74e4658739347b3a2a217bca8f547483ded2126b164f310fe0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ea6ff54807e10aa02dac859a0a71586c0c29b9f47b2fb91246725cda12ea133d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6a4afcda2fdbaa1fd2c3f5e26c1cb3946785567999c2c435268418bbbef9bbb6` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ea6ff54807e10aa02dac859a0a71586c0c29b9f47b2fb91246725cda12ea133d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Java nis me përplasje! Meri Shehu ngre alarmin për disa shenja Lexo lajmin e plote →

Kapuçino, makiato apo kafe me qumësht?/ Ja si ndikojnë te tretja dhe fryrja e barkut Lexo lajmin e plote →

"Ku janë intelektualët, akademikët, shoqëria civile? Kanë fshehur kokën si struci" – Edison Lika: Jeni me Edi Ramën apo kundër tij? Lexo lajmin e plote →

Dështon tentativa e hyrjes së 10 shqiptarëve në Angli, po transportoheshin me një gomone me motorë të fuqishëm! Lexo lajmin e plote →

VIDEO/ Starship hyn për herë të parë në orbitë dhe lëshon 26 satelitë Starlink, por shpërthen gjatë kthimit në Tokë Lexo lajmin e plote →

# Java nis me përplasje! Meri Shehu ngre alarmin për disa shenja

LAJMIFUNDIT / 28 SEPTEMBER 2026, 21:27 Shperndaje

SOFT



Astrologia Meri Shehu ishte e ftuar në emisionin "Rudina", ku foli për ndikimet astrologjike të kësaj jave, për 12 shenjat e zodiakut. Ajo dha vlerësimin me yje për secilën shenjë, ku duket se më e mira ishte për Akrepët dhe një javë aspak e favorizuar për Virgjëreshat.

"Sot futet Marsi në Luan, por bëhet gati të përballet me Plutonin në Ujor dhe është një përballje pak e dhunshme, do të thoja, nga ana astrologjike mban shumë tension. Kështu që kujdes, Ujor, Luan, Akrep, Dem, sepse do të keni përballje. Në përgjithësi, të gjithë do të kemi përballje ditët e para. Plus, edhe Mërkuri futet në Akrep, bëhet më i fshehtë, më i thellë, më absolut, kërkon vendime dhe gjykime të prera dhe nuk fal, se dhe ai do të përballet me Marsin, do të përballet edhe me Plutonin, kështu që nuk na presin ditë kaq të qeta, do të thoja unë", tha astrologia mbi atmosferën e javës.

**Ja si parashikohet kjo javë për secilën shenjë:**

**Dashi – 3 yje**

Me tre yje, sepse Marsi gjithsesi që futet në Luan i jep një impakt pozitiv, po Dashët do të bëhen shumë fanatikë të një plani, të një projekti krijues të tyre dhe do ta çojnë me do e mos në fund. Kjo mund të sjellë disa probleme, disa përballje të fuqishme, të cilat mund të ndërmarrin dhe rreziqe. Por rreziqet ekonomike do të fillojnë të jenë më të fuqishme dhe çështjet personale fillojnë dhe kthehen prapë pak mbrapsht për Dashët. Me rikthimin e Afërditës së kundërt, nga nesër-pasnesër do të shikojnë një hutim.

**Demi – 1 yll**

MOTI NE TIRANE
Tirana, Albania

POLITIKË
A është i zhgënjyer nga politika? MC Kresha flet pa dorashka

POLITIKË
FOTOLAJM/ U komandua në krye të SHISH pas shkarkimit të Hysenit, Elvis Lila për herë të parë në publik

TRENDING

Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencues dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë

Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë

Marsi në Luan nuk i favorizon fare, as Jupiteri në Luan. Marsi në Luan përballet me Plutonin në Ujor dhe çështjet familjare, debatet, paqartësitë duhen parë me kujdes. Dhe në fushën e bashkëpunimeve kemi disa përballje shumë të rëndësishme, sqarime shumë të rëndësishme, hetime, dyshime, xhelozi, kështu që Demët me kujdes këtij jave.

**Binjakët – 2 yje**

Mërkuri në Akrep që futet sjell trazira dhe pasiguri në lidhje me bashkëpunëtorët në punën e tyre, në çështjet ligjore, komunikimet me jashtë, udhëtimet dhe projektet. Por dhe marrëdhënia me njerëzit e afërt nuk do të jetë favorizuese, kështu që shumë Binjakë do të jenë "nën sulme".

**Gaforrja – 2 yje**

Hëna e plotë në fushën e karrierës nuk ishte e favorizuar. Shpëtojnë nga Marsi në shenjën e tyre mbas dy muajsh, shumë i dhunshëm Marsi në shenjën e tyre. Kishin dhe Mërkurin e kundërt në shenjën e tyre, pastaj u fut dhe Marsi. Shpëtojnë nga Marsi, po ky shpëtim nga Marsi është si një lloj lehtësimi, por futen përsëri në një dallgëzim të fuqishëm që prek çështjet ekonomike, personale, diskutime të vështira në projekte dhe në planet e tyre. Plus, janë akoma nën efektin e Hënës së plotë dhe dy javë, kështu që kemi akoma zhgënjime dhe kujdes. Kujdes ekonominë njëherë këto dy-tri ditët e para të javës.

**Luani – 3 yje**

Luanët duan me do e mos të dalë ajo që mendojnë ata, ajo që planifikojnë ata. E kanë në karakter, sepse ata duan të vendosin vulën, po tani e kanë akoma më shumë, se Marsi futet në shenjën e tyre. Marsi është i mirë, por përballet direkt me Plutonin në Ujor, ndaj kujdes me bashkëpunimet.

**Virgjëresha – 1 yll**

Çfarë ndiejnë Virgjëreshat: një pakënaqësi, një gjendje jo të qartë me veten e tyre, sepse në plane nuk po shikojnë ose planet nuk po i shikojnë shumë të qarta diskutimet. Dhe plus, Marsi në Luan është në shtëpinë e 12-të për ta. Kjo do të thotë që edhe kanë kundërshtime vetes, por fillojnë edhe fuqizohen kundërshtarët ose ata njerëz që mendonin se i kishin aleatë. Dhe duket sikur vjen në një sulm të çuditshëm. Kështu që do të ketë një lodhje psikologjike, prandaj pasiguritë, prapaskena fillojnë prapë të bëhen më aktive. Kështu që kujdes dhe me shëndetin, Virgjëreshat.

**Peshorja – 3 yje**

Peshoret janë në atë fazën që jeta emocionale, sentimentale do të jetë ajo që vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes. Kishin Mërkurin deri sot në shenjën e tyre, komunikuan, kishin njohje të reja, jeta shoqërore shumë e mirë. Dhe ato pasuri që krijohen këto kohë me Afërditën e kundërt që është në Akrep, në jetën e tyre personale dhe ekonomike do t'i diskutojnë me shoqërinë dhe me njerëzit e afërt, por këtu do të bëhen akoma pak më konfuzë. Prandaj marrin këtë tre pikësh, sepse e kanë Diellin në shenjën e tyre. Të shikojnë të ekuilibrohen, sepse të tjerët ndoshta do t'i nxjerrin përsëri nga vetja. Megjithatë, kemi pasiguri ekonomike të forta gjatë kësaj jave.

**Akrepi – 4 yje**

Janë me katër yje, sepse Afërdita është në shenjën e tyre. Kthehet e kundërt, por u jepet një mundësi Akrepëve të rregullojnë disa projekte ose disa marrëdhënie, ose të rishikojnë gabimet që janë bërë në jetën e tyre personale, apo të rregullojnë bazën e tyre ekonomike. Por në një çështje karriere krijohet një ndikim shumë i fuqishëm me përballje të forta kësaj jave, të paktën deri në fillim të javës tjetër. Pra, nuk u hapet kollaj porta dhe dera, pavarësisht se kanë katër yje dhe ndoshta mund të bëhen dhe pak më agresivë në mënyrën e komunikimit. Prandaj kujdes dhe Akrepët në mënyrën se si do të tentojnë të marrin atë vrullin për gjërat që mendojnë se u arrijnë ose u kanë e i meritojnë, në fund të fundit.

**Shigjetari – 2 yje**

Komplet të pasigurtë Shigjetarët në këtë periudhë, sepse Afërdita në shtëpinë e 12-të të tyre, ndjehen si të provokuar, njerëz si të tradhtuar. Ndihen si të pasigurtë, qoftë ekonomikisht, qoftë nga ana personale. Plus dhe disa debate që mund të bëhen, apo dhe disa të fshehta që të tjerët


POLITIKË

**Kryeministri mbledh drejtuesit e PS-së dhe ministrat/ Zbulohet fokusi i takimit**

POLITIKË

**Dokumentet e "Homeland Justice": Vlora Hyseni mori urdhra nga dy rusë, akuza të forta nga gazetari (FOTO)**

ME TE LEXUARAT

"Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...
Lexo lajmin e plote

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
Lexo lajmin e plote

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!...
Lexo lajmin e plote

tentojnë t'jua nxjerrin, pra kemi një frymë pak konfliktuale dhe jo mbështetëse kësaj jave.

**Bricjapi – 2 yje**

Shumë vështirë diskutimet, sidomos në çështjet e punëve e në çështje familjare. Plus, Hëna e plotë në shenjën e Dashit futi disa të mira, por gjithashtu dhe një zhgënjim në mes dhe kjo do të dalë këtë kohë. Ambienti nuk do të jetë shumë pozitiv, kështu që Bricjapët të kenë kujdes në çështje familjare, diskutime me të afërmit dhe projektet dhe punët e punëve të përditshme.


**LEXONI GJITHASHTU**



**Kapuçino, makiato apo kafe me qumësht?/ Ja si ndikojnë te tretja dhe fryrja e barkut**



**"Ku janë intelektualët, akademikët, shoqëria civile? Kanë fshehur kokën si struci" – Edison Lika: Jeni me Edi Ramën apo kundër tij?**



**Dështon tentativa e hyrjes së 10 shqiptarëve në Angli, po transportoheshin me një gomone me motorë të fuqishëm!**


**Ujori – 3 yje**

Në këtë ndikim të madh yjesh, Marsi në Luan përballë shenjës së tyre, Plutoni është në shenjën e tyre, kështu që duan të bëjnë një bashkëpunim të fortë. Është një javë që i përball me gjëra më të forta nga sa e mendoni, kështu që mund të surprizohen pak nga disa pasiguri, përballje dhe paqartësi. Ndoshta dhe ndonjë "jo" që mund t'u thuhet në fushën e ndonjë bashkëpunimi. Megjithatë, efekti i Hënës së plotë ishte pozitiv. Këtu do të rikthehen disa situata që duan t'i rregullojnë, kryesisht ekonomike ose bashkëjetesa.

**Peshqit – 2 yje**

Kanë marrë shumë përsipër dhe është e lodhshme. Kujdes me punën, janë në një situatë që u jep pak tension më shumë se sa duhet, do të ndihen të pasigurtë, do të nervozohen, do të duan të lënë punën, do të duan të bëjnë një debat. Megjithatë, Afërdita që kthehet e kundërt në Akrep tenton t'u ndihmojë disa çështje ligjore ose një zhbllokim të parave të prapambetura apo të situatave të prapambetura nga e kaluara, qoftë dhe në jetën personale.


**ME TE LEXUARAT**

"Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e Gjovalin Lazrit

Lexo lajmin e plote



**NA SHKRUAJ**

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

Kliko për më shumë informacion

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
Lexo lajmin e plote

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!
Lexo lajmin e plote

"Askush nuk është mbi ligjin"/ Rama shkarkon menjëherë Vlora Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH
Lexo lajmin e plote

Sekuestrohet hoteli "Central Park Premium" në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket
Lexo lajmin e plote

"Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot"/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap
Lexo lajmin e plote

LAJMI FUNDIT KUSH JEMI KONTAKT REDAKSINË TE DHENAT PERSONALE COOKIES

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by Mediadesk

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do te merrni njoftime periodike me Lajmet e Fundit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.